



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:118986

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06341736

C.nr.848/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ, duke vendosur në çështjen juridike - kontestimore të paditëses K., Distrikti në Gjakovë, e përfaqësuar nga A. M., zyrtare ligjore sipas autorizimit në lëndë, ndaj të paditurit V.R., nga fsh. . . ., K- Gjakovë, e përfaqësuar nga i autorizuari Agim Muhaxhiri, avokat në Gjakovë, për kompensimin e dëmit material, vlera e objektit të kontestit kontesti 798.36 euro, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor - publik të mbajtur me datë 17.10.2024 në prezencën e të autorizuarës së paditëses dhe të autorizuarit të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses K., Distrikti në Gjakovë dhe DETYROHET i padituri V.R., nga fsh. . . ., K- Gjakovë, që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguaj shumën prej shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë euro e tridhjetë e gjashtë cent (798.36 €), me kamatë ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data 08.06.2021 (data paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.
- II. DETYROHET i padituri V.R., që paditëses K., Distrikti në Gjakovë t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej njëqind e shtatëdhjetë euro (170.00€), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

I. Kërkesëpapia dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate me datë 08.06.2021, ka parashtruar padi ndaj të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 798.36 Euro, duke theksuar se i padituri me qëllim që veti t'i sjellë pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njehsorit elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këto veprime energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast paditëses i është shkaktuar dëm material në shumë prej 798.36 Euro. E paditura me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.754/19, të datës 20.01.2020, i cili ka marrë formën e prerë me datë 07.02.2020, Aktgjykimit me numër P.nr.674/18, të datës 05.12.2019, i cili ka marrë formën e prerë me datë 14.02.2020, dhe Aktgjykimit me numër P.nr.404/19, të datës 21.07.2020, i cili ka marrë formën e prerë me datë 02.02.2021 është gjykuar për shkak të kryerjes së veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314/6-1 të Kodit Penal të Kosovës, ndërsa e dëmtuara – tani paditësja, është udhëzuar që dëmin e shkaktuar nga kryerja e kësaj vepre penale ta realizoi në kontest civil.

E autorizuar e paditëses, përgjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare, ndër të tjera ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë si dhe të gjitha deklarimeve nga seanca e kaluar, dëmi i shkaktuar në vlerë prej 798.36 euro vërtetohet në bazë të aktgjykimit penale P.nr.754/19 të datës 20 janar 2020 i cili ka marr formën e prerë me datë 07 shkurt 2020 si dhe procesverbaleve mbi konstatimin e gjendjes faktike në teren me saktësisht procesverbali numër 2505481 i datës 19 qershor 2018 dhe proces verbali me numër 2525688 i datës 06 tetor 2018 si dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes ku njëherit i dorëzojmë edhe gjykatës në kopje të mjaftueshme dhe arsyetoi se në seancën e kaluar të njëjtat prova nuk kam mundur ti prezantoi në seancë për shkak se të njëjtat nuk ka mundur të i siguroi dhe kërkojmë që të njëjtat të bashkëngjiten në shkresat e lëndës si prova. Duke shtuar se nga kontrollimi i bërë tek i padituri nga personat e caktuar kanë konstatuar se me rastin e kontrollimit njehsori ka qenë i shkyçur ky nga ky konstatim rezulton se njehsori nuk ka regjistruar energjinë elektrike e cila ishte shpenzuar në atë periudhë, dëmi i shkaktuar vjen si rrjedhojë nga mos regjistrimi i energjisë elektrike në njehsorin e të paditurit me DGJ102249.

Mënyra e shkaktimit të dëmit është vërtetuar nga persona të autorizuar të cilët duke u bazuar në nenin 3 pika 1 të procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike e miratuar në ZRRE, qëllimi i ë cilës caktohet me nenin 1 të kësaj rregullore

ku thuhet se “ qëllimi i kësaj është procedurë është që të mundësoi punëtoreve të autorizuar të K.-it që në kompetencë të ndërmarrin veprime për identifikim , inspektim , konstatimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë si dhe veprime për realizimin e kompensimit nga konsumatori këtu i padituri për shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike.

Manipulimi i konstatuar është vërtetuar edhe me nenin 33 të rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike i cili përcakton se “nëse konsumatori kryen një nga shkeljet si :manipulimin , anashkalimin e matëses së energjisë elektrike, lidhjen ose rilidhjen pa autorizim për furnizim me energji elektrikë konsiderohet si keqpërdorim i energjisë elektrike “ andaj me veprimet e të paditurit e të cilat janë të specifikuar me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike i padituri paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 798.36 euro. Andaj i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë ta aprovoi në tërësi si të bazuar e po ashtu ta obligoi të paditurin në kompensimin e shpenzimeve procedurale përkatësisht në shumë prej 20 euro për taksë gjyqësore të padisë si dhe shumën prej 150.00 euro për ekspertizë të përpiluar nga eksperti i elektros.

I autorizuari i të paditurit përgjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare, ndër të tjera ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë parashtrimeve, përgjigjes në padi të datës 14 korrik 2021, parashtrimeve në seancën e datës 13 mars 2024 dhe shtoi: edhe me tutje paditësja nuk e ka rregulluar padinë –kërkese padinë në kuptim të dispozitave ligjore të LPK-së. Paditësja bazohet në aktgjykimin P.nr.754/19i plotfuqishëm nga data 07 shkurt 2020 mirëpo ky aktgjykim rezulton se dëmi është shkaktu apo ka mundur të shkaktohet me datën 18 maj 2018, prandaj gjitha pretendimet për rastit e shkaktimit të dëmit të mëvonshëm sipas datave që i kërkon paditësi janë të pabazuara për faktin se pretendimet e paditëses për dëmin e supozuar të shkaktuar me datë 19 qershor 2018 dhe për dëmin e supozuar kinse i është shkaktuar paditëses me datën 06.10.2018 janë të pabazuara për faktin se e paditura në çështjet penale të supozuar është liruar nga përgjegjësia penale , pra nuk ka mundur të konstatohet fajësia e tij për faktin se nuk i ka shkaktu dëm paditëses , mu për këtë fakt pretendimet e paditëses janë të pabazuara .Nga arsyet e cekura më lartë trajtoi se kërkesë padia është nga dy baza e pathemeltë. Dëmi i supozuar i shkaktuar me datën 18 maj 2018, edhe pse është i shkruar në aktgjykimin penale P.nr.754/19 datë 20 janar 2020 , GJTHGJ nuk do të thotë se i është shkaktuar me të vërtet dëm paditëses në lartësinë e shumës 252.81 euro, ky konstatim është pretendim i paditëses dhe se me të vërtet a i është shkaktuar ky dëm paditëses duhet të vërtetohet nëpërmjet ekspertit përkatës të

elektroteknikës - elektro inxhinier e jo ti besohet konstatimit të komisionit të njëanshëm të punëtorëve të paditëses të cilët për ne janë të pabesueshëm dhe jo profesional e legjitim të bëj një vlerësim të tillë sipas dispozitave të LPK-së, si dhe r arsyen tjetër kërkesë padia për këtë pjesë të borxhit në lartësi prej 252.81 euro është e parashkruar, ndërsa për pjesën e borxhit tjetër që pretendon paditësja për lartësinë edhe prej 545,55 euro është e pabazuar meqenëse në aktgjykimet e kësaj gjykate P.nr.674/18 datës 13 dhjetor 2019 dhe aktgjykimin p.nr.40-4/19 datës 3 gusht 2020 i padituri në cilësinë e të pandehurit është liruar nga përgjegjësi penale nuk është vërtetu se në mënyrë të paligjshme ka konsumu apo shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të kundërligjshme. Tutje në fjalën përfundimtare ka theksuar se sa i përket kërkesë padisë së paditëses, për shumën e borxhit prej 798.36 euro si shumë komulative për tri dëme të supozuara të shkaktuara nga i padituri nuk qëndrojnë me sa vijon: pjesa e shumës së borxhit kryesor shuma prej 252.81 euro , për rastin e datës 18 maj 2018, trajtoi se është e parashkruar, për rastin e datës 19 qershor 2018, pjesa e shumës së borxhit total që është e cekur me lartë por vetëm për këtë datë është 379.21 euro dhe për shumën e borxhit në lartësi prej 166,34 euro për datën 6 tetor 2018 nuk ka bazë juridike të cilën edhe në seancën e sodit ekspertit u deklarua se ekspertizën e elektros e ka bazua vetëm në procesverbalet e përpiluara nga ana e paditëses e jo nga aktgjykimet e deponuara në shkresat e lëndës. Mu për këtë kam bërë vërejtje në ekspertizë pjesërisht jo pse kalkulimi nuk është i saktë por vërejtjen e kam bërë për qëllim për nga baza e përgjegjësisë. Nga kjo që u tha më lartë i propozoi gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta hudhë poshtë si të parregullt meqenëse se paditësja përgjigjen në padi të parashtruar nga i padituri e ka pranuar me kohë përgjith kësaj çka u tha më lartë propozoi që të refuzohet kërkesë padia e paditëses edhe si e pabazuar. Në qoftëse gjykata merr aktgjykim të pjesërishtëm kërkoi nga gjykata që të detyrohet paditësja që të bej kompensimin e shpenzimeve procedurale 2/3 dy thye për tre te suksesit në padi të cilat kapin shumën e përgjithshme prej 482,60 euro përkatësisht 2/3 e suksesit është 336.00 euro, për përgjigje në padi dhe 4 seanca, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Provat e administruara lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Ekspertiza nga lëmia e elektros e datës 21 qershor 2024; Aktgjykimi P.nr. 754/19 i datës 20 janar 2020; Fatura e kalkulimit më numër 247090 e datës 21 maj 2019; Fatura mbi llogaritjen e dëmit DGJHP198489 e datës 21 maj 2019;

Aktgjykimi P.nr.674/18 i datës 05 dhjetor 2019; Fatura e kalkulimit më numër 186240 e datës 21 qershor 2018; Fatura mbi llogaritjen e dëmit DGJP187609 e datës 21 qershor 2018; Aktgjykimi P.nr.404/19 i datës 24 korrik 2020; Fatura e kalkulimit më numër 205763 e datës 09 tetor 2018; Fatura mbi llogaritjen e dëmit DGJHP187829 e datës 09 tetor 2018,

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e zbatuara Gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në vijim.

Nga Ekspertiza nga lëmia e elektros e datës 21 qershor 2024, të përpiluar nga eksperti i elektros S. G., gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri: ka bërë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe është lidhur direkt në dalje të njehsorit – neni 3. Kalkulimet e fuqisë dhe faturimi janë të sakta që janë bërë nga K.-i, si procesverbalet nr-2505481i datës 19.06.2018; procesverbali nr- 2525688 i datës 06.10.2018 si dhe procesverbali nr-2534777 i datës 18.05.2019 e ku llogaritja është bërë në bazë të rregullorës nr-14 neni 14.5 ku ceket se: Në rastet kur ekipeve të autorizuara nuk ju lejohet qasja në objektet e banimit (shtëpi, banesë) për sigurimin e shënimeve të pajisjeve elektrike të instaluar, KEK-u do të aplikojë llogaritjen e shpenzimit të paautorizuar në mënyrë paushalli për muaj 1,100 kËh për konsumatorët në banesa. Pra, në lidhje me rikthimin e humbjeve si dhe ngarkimi për konsumatorin që ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar është 798.36 euro. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.10.2024 eksperti është ftuar për të dhënë sqaritmet në ekspertizën e tij dhe I njejti ka deklaruar se: qëndroi pranë ekspertizës së përpiluar dhe dorëzuar në këtë me datë 21 qershor 2024. Ekspertiza është përpiluar duke u bazuar në procesverbalet e lëshuar nga K.-i si dhe nga dokumenti i lëshuar nga ZRRE si dhe dokumentet e ofruara nga shkresat e lëndës.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.754/19, të datës 20.01.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari, këtu i padituri, V.R., është shpallur fajtor për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 314 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së, ku me veprimet e saj i ka shkaktuar dëm paditëses në vlerë prej 252.81 euro, me ç ‘rast e dëmtuara, këtu paditësja, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Nga Aktgjykimi P.nr.674/18 i datës 05 dhjetor 2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari V.R., është liruar nga për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 314 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe e dëmtuara këtu paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil.

Nga Aktgjykimi P.nr.404/19 i datës 24 korrik 2020, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari V.R., është liruar nga për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 314 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe e dëmtuara këtu paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil.

Nga Fatura e rikthimit të humbjeve me ID të rastit 247090 e datës 21 maj 2019, e lëshuar nga KESCO, Divizioni i Furnizimit-Sektori i Rikthimit të Humbjeve, nëpërmjet së cilës është bërë kalkulimi i energjisë elektrike të shfrytëzuar pa autorizim nga i padituri, gjykata ka vërtetuar faktin se llogaritja e dëmit të paditëses nga veprimet e të paditurit është bërë në bazë të pajisjeve elektrike të cilat kanë qenë në funksionim deri me datë 18.05.2019.

Nga fatura me numër mbi llogaritjen e dëmit DGJHP198489 e datës 21 maj 2019, e lëshuar nga paditësja, gjykata ka vërtetuar faktin se dëmi që i është shkaktuar paditëses nga shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë nga e paditura është në shumë prej 252.81 euro.

Nga fatura e rikthimit të humbjeve me ID të rastit 186240 e datës 21 qershor 2018, e lëshuar nga KESCO, Divizioni i Furnizimit-Sektori i Rikthimit të Humbjeve, nëpërmjet së cilës është bërë kalkulimi i energjisë elektrike të shfrytëzuar pa autorizim nga i padituri, gjykata ka vërtetuar faktin se llogaritja e dëmit të paditëses nga veprimet e të paditurit është bërë në bazë të pajisjeve elektrike të cilat kanë qenë në funksionim deri me datë 19.06.2018.

Nga fatura mbi llogaritjen e dëmit DGJP187609 e datës 21 qershor 2018, e lëshuar nga paditësja, gjykata ka vërtetuar faktin se dëmi që i është shkaktuar paditëses nga shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë nga e paditura është në shumë prej 379.21 euro.

Nga fatura e fatura e rikthimit të humbjeve me ID të rastit 205763 e datës 09 tetor 2018, e lëshuar nga KESCO, Divizioni i Furnizimit-Sektori i Rikthimit të Humbjeve, nëpërmjet së cilës është

bërë kalkulimi i energjisë elektrike të shfrytëzuar pa autorizim nga i padituri, gjykata ka vërtetuar faktin se llogaritja e dëmit të paditëses nga veprimet e të paditurit është bërë në bazë të pajisjeve elektrike të cilat kanë qenë në funksionim deri me datë 06.10.2018.

Nga fatura mbi llogaritjen e demit DGJHP187829 e datës 09 tetor 2018, e lëshuar nga paditësja, gjykata ka vërtetuar faktin se dëmi që i është shkaktuar paditëses nga shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë nga e paditura është në shumë prej 166.34 euro.

III. Ligji i zbatueshëm dhe vlerësimi i gjykatës.

Me neni 137 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), parashihet që *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*, ndërsa po në këtë ligj, në dispozitat e nenit 136 par. 1 është përcaktuar se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë t’ua kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, e po ashtu në nenin 358, par.1 të LMD-së, është përcaktuar se: *“Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”*. Në anën tjetër me neni 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) parashihet që *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.*

Gjykata pas administrimit të provave, vlerësimit dhe analizimit të tyre, pretendimet e paditëses se e paditura i ka shkaktuar dëm paditëses i gjen të bazuara. Nisur nga fakti se i padituri me Aktgjykimin P.nr.754/2019, të datës 20.01.2020, është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314.6 i KPRK-se, rrjedh se për gjykatën është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që në rastin konkret gjykata lidhet me aktgjykimin penal i cili është i formës së prerë ku është vërtetuar përgjegjësia penale e të paditurës. Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke marrë për bazë Ekspertizën nga lëmia e elektros, e datës 21 Qershor 2024, sipas të cilës është konstatuar se i padituri me shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të pa autorizuar i ka shkaktuar dëm palës paditëse në vlerën prej 798.36 Euro. Ekspertizën nga lëmia e elektros gjykata e ka vlerësuar si profesionale, të

argumentuar mirë dhe të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme, ngase e njëjta kishte ofruar të dhëna të nevojshme lidhur me rastin kontestues, sipas aktvendimit të gjykatës me të cilin ishin dhënë detyrat e ekspertimit.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimet e të paditurit në përgjigjen në padi, përgjatë seancës së shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën përfundimtare lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar, ngase në rastin konkret gjykata ka vërtetuar faktin se dëmi është shkaktuar me vepër penale për të cilën vepër penale konform Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), me të cilin është gjykuar i akuzuari, këtu i padituri, është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite, ndërsa afati i parashkrimit të ndjekjes penale sipas nenit 99, par.1, pika1.5, është *gjashtë (6) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim*. Ndërsa në nenin 100, par.7 të KPRK-së është paraparë se *ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit*, që nënkupton se afati absolut i parashkrimit të ndjekjes penale për këtë vepër penale është 12 vite nga koha e kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret, nuk gjejnë zbatim dispozitat e nënti 357, par.1 të LMD-së, ku është përcaktuar se: *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.”*, por, meqenëse dëmi është shkaktuar me vepër penale, gjejnë zbatim dispozitat e nenit 358, par. 1 LMD-së, ku është përcaktuar se: *“Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”*, kjo ngase afati i parashkrimit të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par 6 lidhur me par.1 i KPRK-së, është më i gjatë se afati i parashkrimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit, nga neni 357, par.1 të LMD-së. Prandaj meqenëse dëmi është shkaktuar me datë 18.05.2018, ndërsa padia pranë kësaj gjykate është parashtruar me datë 18.06.2021, rrjedh se në këtë rast që nga shkaktimi i dëmit e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar 2 vite e 10 muaj, pra nuk kemi parashkrim të kërkesës së paditëses.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se i padituri me veprimet e tij paditëses i ka shkaktuar dëm në lartësi prej 798.36 Euro, fakte këto që u vërtetuan nga provat e administruara dhe të elaborara si më lartë. Andaj si rezultat i kësaj gjendje faktike të vërtetuar e në zbatim te dispozitave ligjore nga neni 136 të LMD-së, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD-së, dhe kamata është llogaritur prej e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u mor sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, dhe suksesit në kontest, me ç' rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 170,00 €, në emër të përpilimit të ekspertizës nga lëmia e elektros 150.00 €, si dhe në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi 20.00 € (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, e në kuptim të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.848/21, me 24 Tetor 2024

Gj y q t a r j a
Blerina KURTAJ

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.